



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 128, Datë 08/10/2015

Pasi u njoh me ankesën nr. 8, datë 02.02.2015 të shtetases Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrotjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrotjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 8, datë 02.02.2015, e Znj. , ku pretendohet për diskriminim të saj për shkak se ka qenë e ndjekur penalisht në të kaluarën, nga ana e Z , Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, profesioni i ankueses është “mjeke e përgjithshme”. Ajo ka punuar në pozicionin e specialistes në Degën e Përfitimeve Afatshkurtëra, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier dhe është larguar nga detyra, nëpërmjet Vendimit nr. 2677/2, datë 03.10.2014, të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier. Sipas ankueses, shkeljet e përmendura në këtë vendim janë të pajustifikuara dhe të pambështetura në prova e fakte. Znj. thekson faktin se ndaj saj nuk është marrë asnjë masë tjetër disiplinore paraprakisht, por menjëherë i është dhënë një masë tepër ekstreme, ajo nëpërmjet vendimit për largim nga puna. Gjithashtu, ajo e bën me dije Komisionerin, mbi faktin se observacionet e saj nuk janë marrë parasysh nga Drejtori i DRSSH Fier, si dhe struktura përkatëse e ISSH-së nuk i është përgjigjur ankimit administrativ, që ajo ka paraqitur pranë këtij institucionit pas largimit të saj nga puna. Ankuesja thekson se gjatë kryerjes së detyrave të saj, ajo është mbështetur në Rregulloren e institucionit, pa kryer asnjë devijim nga parashikimet e detyrave të përcaktuara nga kjo rregullore.

Për të marrë informacion më të detajuar rrëth çështjes së parashtruar nga Znj. ankueses iu kërkuar të paraqitej në një takim, pranë KMD-së, në datën 03.02.2015. Gjatë takimit, ankuesja u pyet mbi shkakun e diskriminimit, pasi në formularin e ankesës, ishte shënuar opzioni “për çdo

shkak tjetër”, duke mos identifikuar një ndër shkaqet e përcaktuara në ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, por as edhe ndonje shkak tjetër konkret. Referuar procesverbalit të takimit, ankuesja fillimisht u përgjigj se nuk e identifikonte dot shkakun e diskriminimit, por mendonte se ishte “humbja e besimit të drejtorit ndaj saj si punonjëse”. E pyetur, se përse ajo mendonte se kishte humbur besimi i drejtuesit të saj, tek ajo si punonjëse, Znj. ↳ qaroi se në vitin 2011, ajo ka qenë në ndjekje penale nga Prokuroria e Rrethit gjyqësor Fier, për kryerjen e veprës penale “korruption pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, 2 herë, parashikuar nga nenet 259-25 të Kodit Penal. Por, me vendimin nr. 279, datë 19.07.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ajo është deklaruar e pafajshme për veprën penale të sipërpërmendur¹. Në këtë kontekst, ankuesja pretendoi se pikërisht, ngaqë ajo ka qënë e ndjekur penalisht nga e Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, ajo është paragjykuar nga drejtori i DRSSH Fier, i cili nuk ka patur besim tek ajo si punonjëse dhe si rrjedhim e ka larguar nga puna. Ajo e konsideron veten të diskriminuar pikërisht për këtë shkak.

E pyetur sërisht, nëse kishte punonjës të tjerë të institucionit, të cilët ishin në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, të cilët ishin trajtuar ndryshe, ankuesja theksoi faktin se nuk kishte të tillë. Njëkohësisht, ankuesja theksoi se asnjë prej pikave të përmendura në vendimin nr. 2677/2, datë 03.10.2014, nëpërmjet së cilit ajo është larguar nga puna, nuk ishte e justifikuar ligjërisht. Ajo kishte paraqitur observacionet e saj, lidhur me këtë vendim, por këto observacione nuk ishin marrë parasysh nga ana e drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Z.

Znj. ↳ sqaroi faktin se ndaj saj nuk ishte marrë paraprakisht ndonjë masë disiplinore, por ishte kaluar në mënyrë të drejtpërdrejtë në një masë disiplinore ekstreme, siç ishte ajo e largimit nga puna. Ankuesja kishte paraqitur ankesë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, në muajin tetor 2014, por ky institucion nuk i kishte kthyer asnjë përgjigje.

Hapat proçeduriale të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit të ankesës nr. 8, datë 02.02.2015 të shtetasës u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsy, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloj proçedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
2. Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, me shkresën nr. 129/1, datë 09.02.2015, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e ankueses

¹Ky vendim u la në fuqi nëpërmjet vendimit nr. 290, datë 08.06.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjithashtu me vendimin nr. 00-2014-963, datë 26.06.2014, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokurori i Apelit Vlorë, kundër vendimit nr. 290, datë 08.06.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Në përgjigje të shkresës nr. 129/1, datë 09.02.2015, të Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier informoi mbi çështjen e Znj. nëpërmjet shkresës nr.458/1, datë 27.02.2015.

Sipas këtij infomacioni Komisioneri informohet se Znj. ka qenë punonjëse pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier në detyrën “mjeke specialiste në sektorin e përfitimeve afatshkurtëra” për periudhën 23.06.2000 – 30.07.2010, datë në të cilën u pezullua nga detyra për shkak të ndjekjes penale që kishte filluar në ngarkim të saj nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier. Pezullimi u krye në mbështetje të Rregullores nr. 2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Kreu IV, pika 2, “Pezullim nga puna” ku parashikohet se: “*Punonjësi pezullohet kur ndaj tij fillon ndjekja penale për shkak të detyrës ose për krime të rënda, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar*”. Pas përfundimit të procesit gjyqësor, i cili e shpalli ankuesen të pafajshme, punonjësja është kthyer në detyrën e mëparshme, përkatësisht në datën 05.12.2012, ku ka vazhduar të punojë deri më 05.01.2015, kur janë ndërprerë edhe marrëdhëniet e punës me DRSSH Fier.

Sipas shkresës së sipërpërmendur, zgjidhja e kontratës është kryer për shkaqe të justifikuara, duke respektuar me përpikmëri Kodin e Punës, lidhur me procedurën e zgjidhjes së kontratës, afatin e njoftimit sipas vjetërsisë së saj në punë etj. Motivacioni i zgjidhjes së kontratës së punës me DRSSH Fier i është komunikuar shkresërisht ankueses. Gjithashtu, ankuesja është sqaruar edhe gjatë takimit për bisedime, duke i parashtuar të gjitha shkaqet dhe arsyet si më poshtë, që çuan në marrjen e Vendimit nr. 2877/2, datë 03.10.2014, të Drejtorit të DRSSH Fier.

Motivacioni i zgjidhjes së kontratës së punës së ankueses sipas vendimit të sipërpërmendur, përfshin pikat e mëposhtëme:

- a-** Punonjësja ka kryer shkelje të rënda, të cilat kanë sjellë vonesa ne pagesat e përfitimeve të qytetarëve.
- b-** Ndaj kësaj punonjësie ka patur ankesa të shumta nga qytetarët dhe mjekët e Qendrave Shëndetësore, të cilat janë vërtetuar dhe theksojnë se kontrolllet e ushtruara nga mjekja nuk kanë qenë objekt i Sektorit të Paaftësisë.
- c-** Verifikimet e kryera nga punonjësja Tushe Qalliu kanë qenë jashtë afateve të kërkuara, gjë që ka sjellë vonesa në pagesën e qytetarëve dhe neglizhencë ndaj detyrës së saj funksionale.
- d-** Gjithashtu, kjo punonjëse ka abuzuar me firmën e drejtorit, në disa prej praktikave të përfitimeve, faktor ky që ka ndikuar në thyerjen e raporteve të mirëbesimit që duhet të ekzistojnë si punëdhënës-punëmarrës dhe pamundësinë e rikuperimit të tyre.

Këtu, theksohet fakti se e gjithë procedura ka qenë transparente, lidhur me verifikimet e kryera dhe komunikimet me ankuesen, ndaj pretendimet e ankueses konsiderohen të pabazuara.

Gjithashtu, për sa i përket pretendimit të ankueses, se kolegia e saj e zyrës ndërhynte në kompetencat e saj, në shkresë sqarohet se Kryetarja e Degës së Përfitimeve, Znj. nuk ka dhënë asnjë informacion zyrtar, për prekje të kompetencave të mjekes.

Ndër të tjera, Komisioneri bëhet me dije nga ana e DRSSH Fier se ka patur ankesa të vazhdueshme nga mjekët e KML-ve, Qendrave Shëndetësore e Spitaleve, ku Znj. Në mënyrë të paautorizuar nga titullari me shkresë zyrtare, gjatë kryerjes së verifikimeve bënte presione të vazhdueshme për vjenie gjobash. Për të shmangur sa më sipër, u vendos që verifikimet të kryheshin mbi programe pune, të miratuara nga drejtori i DRSSH Fier. Por, pavarësisht kësaj, titullari i këtij institucion thekson faktin se nuk figuron asnje plan pune i hartuar dhe i protokolluar dhe në çdo rast Znj. A vepruar me keqbesim, me iniciativën e saj personale dhe duke përdorur forma presioni, të cilat nuk i shkojnë për shtat një punonjësi të zyrave shtetërore, të ngarkuar me ligj për të ushtruar detyrën që i është ngarkuar.

Për sa i përket specialistes tjetër të këtij sektori, pozicioni i saj në organikë ka emërtesen “specialist/ekonomist i përfitimeve afatshkurtëra” dhe detyrat e saj janë të përcaktuara saktësisht në rregulloren e institucionit, ndaj në shkresën e DRSSH Fier theksohet fakti se për këtë arsy nuk kishte kuptim dhe ishte e pamundur që kompetencat, lidhur me çështjet me natyrë mjekësore t'i kalonin për trajtim një ekonomisti.

Njëkohësisht, Drejtori i DRSSH Fier sqaron, se nga verifikimet e kryera rezultoi se kishte shumë praktika të patrajuara dhe të papunuara nga Znj. Këto praktika u nënshkruan nga ankuesja në mbledhjen e muajit maj 2014, në prezencën e disa titullarëve të DRSSH Fier.

Të gjitha arsyet e përmendura më sipër, çuan në marrjen e një vendimi për zgjidhjen e kontratës së punës me Znj.

3. Në vijim të hetimit të ankesës së Znj. Është zbatim të Urdhërit nr. 37, datë 31.03.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier, me qëllim kryerjen e verifikimeve mbi ankesën e Znj.” Në datën 08.04.2015, inspektorët e KMD-së u paraqiten për inspektim pranë këtij institucioni.

Objekti i inspektimit konsistonte, si më poshtë vijon:

- Kryerja e verifikimeve mbi ankesat e qytetarëve, që janë dërguar kundër Znj. pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier.
- Kryerja e verifikimeve mbi ankesat e mjekëve të Qendrave Shëndetësore, që janë dërguar kundër Znj. pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier.
- Verifikimi i rasteve konkrete, ku kontrollet e ushtruara nga mjekja pranë Qendrave Shëndetësore, kanë qenë jashtë kompetencave të saj.
- Informacion mbi faktin, nëse ndaj ankueses është marrë paraprakisht ndonjë masë tjetër disiplinore.
- Verifikimi i rasteve konkrete, ku Znj. a abuzuar me firmën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier.
- Mbledhja dhe administrimi i informacioneve të tjera, që kanë lidhje me çështjen e Znj.

► Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-së u takuan fillimi me Z. me detyrë
 Kryetar i Degës së Administrimit dhe Znj. me detyrë Kryetare e Degës së
 Përfitimeve, të cilët dhanë sqarimet përkatëse lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja.

Z theksoi faktin se procedurat e lirimit nga detyra të Znj. min kryer në
 rregull, sipas dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore. I pyetur në lidhje me faktin, nëse Znj.
 shtë marrë një përgjigje lidhur me observacionet e dorëzuara, pas daljes së Vendimit nr.
 2877/2, datë 03.10.2014, të Drejtorit të DRSSH Fier, Z. u përgjigj se këto observacione
 ishin dorëzuar tek drejtori, i cili i kishte kthyer përgjigje të drejtpërdrejtë ankueses. I pyetur
 gjithashtu, nëse për lirimin nga detyra të Znj. ishin zbatuar procedurat e parashikuara në
 Rregulloren “Për personelin e ISSH-së”, të miratuar me Vendimin nr. 3/2, datë 26.02.2008 të
 Ministrit të Financave, Z. shpreh se në këtë rast nuk ishte krijuar komisioni disiplinor, i
 cili ka kompetenca të veçanta, lidhur me trajtimin e rasteve, kur jepen masa disiplinore për
 punonjësit e ISSH-së.

Referuar Urdhërit të inspektimit, inspektorët e Komisionerit kërkuarn të dispononin kopje të
 ankesave të qytetarëve, të cilat ishin depozituari pranë DRSSH Fier, kundër Znj. Z.
 u shpreh se nuk dispononte ankesa me shkrim dhe të protokolluara të qytetarëve kundër Znj.

Por, ai theksoi faktin se për këtë fakt mund të kishte dijeni Drejtori i DRSSH Fier.
 Ndërkohë që Kryetari i Degës së Administrimit pohoi faktin se pranë tij janë paraqitur disa
 qytetarë që janë ankuar në mënyrë të drejtpërdrejtë (jo zyrtare) për Znj. Z. pohoi të
 njëtin fakt edhe kur u pyet lidhur me ankesat e mjekëve të Qendrave Mjekësore dhe Spitaleve
 kundër ankueses.

Për të sqaruar me hollësishët çështjen e ankesave të paraqitura pranë DRSSH Fier, kundër
 ankueses, inspektorët e Komisionerit u takuan me Znj. Kryetare e Degës së
 Përfitimeve, e cila kishte qenë eprore e drejtpërdrejtë e Znj. theksoi
 faktin se ajo nuk kishte dijeni për ankesa zyrtare të qytetarëve apo mjekëve të Qendrave
 Shëndetësore apo spitaleve kundër Znj. , por shtoi se ajo kishte qenë dëshmitare e
 konflikteve të drejtpërdrejta që Znj. kishte patur brenda ambienteve te institucionit me
 qytetarë të ndryshëm. Për sa i përket planeve të punës, mbi bazën e të cilave ishte vendosur të
 kryheshin verifikimet në terren, Znj. sqaroi se planet e punës së Znj. janë dorëzuar
 dhe janë firmosur nga ajo, në cilësinë e eprores së drejtpërdrejtë. Ndonjëherë, këto plane ishin
 dorëzuar me vonesë, por ajo nuk i kishte kushtuar rëndësi këtij fakti. Kryetarja e Degës së
 Përfitimeve theksoi faktin se ndaj Znj. nuk ishte dhënë asnjëherë paraprakisht ndonjë
 masë disiplinore.

Inspektorët e KMD-së u takuan edhe me specialisten/ekonomiste të Degës së Përfitimeve, Znj.
 cila pohoi faktin se kontrolllet e kryera nga Znj. pranë Qendrave
 Shëndetësore ishin të parregullta, sepse nuk kryheshin në bazë të një programi kontrolli të
 firmosur nga Drejtori, ndërkohë që Znj. duke mos qenë dakord me mendimin e specialistes
 u shpreh se puna e ankueses konsistonte në kryerjen e verifikimeve në terren dhe për këtë arsy
 ishte ndjekur praktika që plani mëjor i këtyre verifikimeve apo kontolleve të hartohej nga Znj.

dhe të miratohej nga Kryetarja e Degës së Përfitimeve, pa qenë i nevojshëm miratimi i Drejtorisë.

Ndërkohë që, Znj. theksuan faktin se Znj. kishte zvarritur përafërsisht 30 praktika, duke mos i firmosur. Ankuesja duhet të nënshkruante, lidhur me pjesën mjekësore të këtyre praktikave dhe si rrjedhim kishte shkaktuar zvarritje dhe vonesa në pagesat e qytetarëve. Ajo vazhdimisht refuzonte t'i firmoste këto praktika. Nënshkrimi i ankeses duhej kryer ne kartelën financiare të individit që paraqet kërkësë për përfitim. Lidhur me çështjen e zvarritjes së praktikave, u ra dakord që DRSSH Fier të dërgonte në ditët në vijim informacion më të detajuar pranë KMD-së. Punonjëset e mësipërme sqaruan faktin se Znj. ndërhynte në kompetecat e tyre, lidhur me çështje të karakterit finanziar, ndërkohë që ajo duhet të trajtonte vetëm çështjet me karakter mjekësor të një praktike të caktuar.

Më tej, Znj. qaroi se rreth 60 praktika në total ishin zvarritur nga ankesja, ndërkohë që 30 prej tyre nuk janë firmosur asnjëherë nga ajo. Ndaj në kushtet e refuzimit të saj, kishte nënshkruar Kryetarja e Degës së Përfitimeve. Znj. shtoi se shpeshhere e kishte këshilluar Znj. i nënshkruante praktikat, duke e siguruar se këto praktika ishin të rregullta, por ankesja shprehej se nuk ishte e bindur për t'i firmosur dhe se kishte frikë të nënshkruante.

Në vijim, inspektorët e Komisionerit u takuan me Drejtorin e DRSSH Fier, Z.

Z. shpreh se Znj. ndërhynte në kompetencat e specialistes tjeter të Degës së përfitimeve, pra në kompetenca të sferës ekonomike dhe jo shëndetësore. Njëkohësisht, Z.

heksoi faktin se kishte patur shumë ankesa jo zyrtare nga qytetarë të ndryshëm në adresë të Znj., sikurse edhe nga mjekët e Qendrave Shëndetësore. Gjithashtu, Drejtori i DRSSH Fier sqaroi se Znj. kishte dorëzuar pranë tij për nënshkrim, praktika që dilnin jashtë kompetecave të saj dhe ai i kishte nënshkruar në mirëbesim. Ai e mohon faktin se ankesja është paragjykuar, lidhur me faktin se ajo ka qenë në ndjekje penale nga prokuroria. Ndër të tjera, Z. shpreh se Znj. oshtë akuzuar edhe për veprën penale të mitëmarrjes nga ana e qytetarëve të ndryshëm, pavarësisht se nuk ishte kryer kurrë kallëzim penal në prokurori dhe çdo gjë ishte e pavërtetuar.

Referuar procesverbalit të inspektimit, Z. Drejtor i DRSSH Fier ka theksuar edhe një herë faktin, se ai nuk kishte kryer veprime diskriminuese ndaj Znj., por ishte treguar i hapur ndaj saj, si dhe kishte respektuar çdo të drejtë ligjore.

- Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore, Komisioneri vendosi që në datën 20.04.2015, të realizojë një seancë dëgjimore, ku palët u ftuan të merrnin pjesë, për të parashtuar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre. Nëpërmjet shkresës nr. 300/2, datë 14.04.2015, palët u njoftuan për seancën dëgjimore dhe iu kërkua të konfirmonin pjesëmarrjen brenda datës 17.04.2015.

Në seancë dëgjimore u paraqitën Z. Drejtor i DRSSH Fier dhe ankesja Tushe Qalliu. Që në fillim të seancës dëgjimore, Znj. parashtroi edhe një herë pretendimet e saj, duke theksuar faktin se është parë ndryshe, që nga momenti që është rikthyer në punë. Z. teksoi faktin se nuk kishte veprime te faktuara, të cilat të demostronin diskriminim të

ankueses. Ai u shpreh se zgjidhja e kontratës së punës ndërmjet ankueses dhe DRSSH Fier ishte kryer në përputhje me dispozitat e akteve ligjore në fuqi. Ai i bëri me dije përfaqësuesit e Komisionerit se ishin zhvilluar 2 mbledhje pranë DRSSH Fier, përkatësisht në muajt prill dhe shtator 2014, në të cilat Znj. ishte njohur me problematikat e parashtruara. Z. pohoi edhe një herë se nuk ka patur asnjë paragjykim për Znj për sa i përket të kaluarës së saj. Për sa i përket specialistës tjetër të Degës së Përfitimeve, ai sqaron se nuk i kishte dhënë asnjë përparësi, në krahasim me ankuesen.

Ndër të tjera, Z. «soi faktin se kishte firmosur në disa raste, në mirëbesim, shkresa të ndryshme të hartuara nga Znj. nga ku kishin dalë probleme të ndryshme. Si pasojë kishin patur ankesa nga mjekët e Qendrave Shëndetësore. Në këto raste, ai sqaron se nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore për Znj. I pyetur, lidhur me observacionet e paraqitura nga Znj. as nënshkrimit të vendimit nr. 2877/2, datë 03.10.2014, për zgjidhjen e kontratës së saj të punës me DRSSH Fier, Z. shpreh se këto observacione nuk ishin gjetur të mbështetuara. Ndër të tjera, ai shprehet se kishte humbur besimin tek Znj lhe nuk mund të firmoste më shkresa të hartuara prej saj.

Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, Z. shtë shprehur: "Po ta kisha mjeke³ të KMCAP-së do ta kisha hequr që në momentin e parë që kam ardhur në punë, pasi nuk do të kisha besim, si rezultat i atyre pamjeve filmike⁴ që janë transmetuar".

Gjatë seancës dëgjimore pati shumë debate ndërmjet palëve dhe përfaqësuesve të Komisionerit dhe në fund të kësaj seance Z. uk ra dakord me përbajtjen e procesverbalit, duke pretenduar se faktet nuk ishin paraqitur në kontekstin që ai i kishte parashtruar. Ai e konsideroi procesverbalin të parregullt, lidhur me paraqitjen e deklarimeve të tij.

Përfaqësuesit e KMD-së i kërkuant që të kryente ndryshimet përkatëse në procesverbal, aty ku ai e konsideronte të nevojshme, ose të hartohej një procesverbal tjetër në bazë të të parit, ku Z. mund të bënte ndryshimet në konteksin e deklaratave të dhëna, por Drejtori i DRSSH Fier refuzoi.

- Në vijim të inspektimit pranë DRSSH Fier dhe seancës dëgjimore të realizuar pranë KMD-së, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier dërgoi shkresën nr. 372⁵, datë 20.04.2015, ku dërgoheshin materialet, lidhur me përgjigjet negative të dhëna nga ankuesja për praktika të ndryshme, kartela të fshira me korrektor, procesverbalet e mbledhjeve të zhvilluara në Drejtori në lidhje me Znj. verifikimet e firmosuar vetëm nga mjekja, kartela të firmosura dhe të pafirmosura nga mjekja edhe kur nuk kanë të plotësuara disa ditë sigurimi, një shkresë për të cilën më parë ka kryer pagesën mjekja, e pas disa muajsh, kjo e fundit ka dorëzuar shkresën për t'u firmosur nga drejtori, si dhe një kartelë financiare të

³ Realisht, ankuesja nuk ka punuar asnjëherë në pozicionin e punës së mjekës së KMCAP-së, por ka punuar në pozicionin e specialistës në degën e përfitimeve.

⁴ Z. referohet disa filmimeve, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me hetimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me Znj.

⁵ Numri i protokollit dhe data e dorëzimit të shkresës pranë KMD-së.

firmosur në muajin qershor, e më pas shkresa për t'u firmosur nga drejtori me përgjigje negative.

- Materialet e mësipërme iu bënë me dije Znj , e cila parashtri kundërshtimet e saj, për secilën praktikë.

Për sa më sipër, gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

Nëpërmjet Vendimit nr. 2877/2, datë 03.10.2014, të Drejtorit të DRSSH Fier është zgjidhur kontrata e punës për shkaqe të justifikuara, të Znj. në cilësinë e punëmarrëses, me DRSSH Fier, në cilësinë e punëdhënësit.

- I- Mbështetur në rezultatet e procesit të hetimit, Komisioneri gjykon se disa prej rasteve të konstatuara që provojnë shkakun e justifikuar të zgjidhjes së kontratës së punës, të këtij Vendimi janë të pambështetura ligjërisht.
- 1- Në këtë kontekst, së pari i referohemi ankesave të qytetarëve dhe të mjekëve të Qendrave Shëndetësore kundër Znj ë cilat nuk janë të depozituara me shkrim dhe të protokolluara pranë DRSSH Fier, në mënyrë që të mund të përdoreshin në cilësinë e provës.
- 2- Së dyti, njëri nga motivacionet e përdorura për largimin nga puna të ankueses është edhe mos hartimi i programeve të punës nga ankuesja, ndërkohë që gjatë procesit të inspektimit të KMD-së rezultoi e kundërtë. Znj tishte hartuar programet e punës, të cilat ishin nënshkruar nga Kryetarja e Degës së Përfitimeve, e cila ka pohuar në prani të inspektorëve të Komisionerit të kundërtën e asaj, që është përdorur si motivacion në Vendimin nr. 2877/2, datë 03.10.2014, të Drejtorit të DRSSH Fier.
- II- Përgjatë procesit të hetimit, Komisioneri konstatoi se procedura e ndjekur për largimin nga puna të Znj. Iuk ka qenë në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren “Për personelin e ISSH-së”, të miratuar me Vendimin nr. 3/2, datë 26.02.2008 të Këshillit Administrativ të ISSH-së. Referuar pikës 3 të kësaj rregulloreje, rasti i Znj. është shqyrtuar nga komisioni disiplinor, i cili ka kompetenca të veçanta, lidhur me trajtimin e rasteve, kur jepen masa disiplinore përunojësit e ISSH-së. Referuar pikës 3.3 të kësaj Rregulloreje, ky komision është i përhershëm. Vendimet e tij⁶ merren me shumicë votash dhe ky komision⁷ garanton

⁶ Pika 3.5 e Rregullores “Për personelin e ISSH-së”.

⁷ Pika 3.6 e Rregullores “Për personelin e ISSH-së”.

zbatimin e rregullave dhe të procedurave disiplinore, bazuar në parimet e drejtësisë, barazisë, prezumimit të pafajsisë etj.

- III-** Pas daljes së Vendimit nr. 2877/2, datë 03.10.2014, të Drejtorit të DRSSH Fier, Znj. depozituar observacionet e saj lidhur me shkeljet e pretenduara në këtë vendim. Këto observacione janë dorëzuar pranë Drejtorit të DRSSH Fier, i cili nuk i ka kthyer asnjëherë përgjigje zyrtare ankueses lidhur me këto observacione. Gjatë seancës dëgjimore, Z. u shpreh se këto observacioni i ka gjetur të pambështetura, por asnjëherë nuk e ka bërë me dije zyrtarisht Znj.
- IV-** Pas realizimit të seancës dëgjimore, u konstatua se Z Drejtor i DRSSH Fier, (pavarësish se ky i fundit nuk ra dakord me përmbajtjen e procesverbalit), ishte i ndikuar nga fakti se Znj. ka qenë dikur në ndjekje penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier për veprën penale “korruption pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, 2 herë, parashikuar nga nenet 259-25 të Kodit Penal. Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, Z. shtë shprehur: *“Po ta kisha mjeke të KMCAP-së⁸ do ta kisha hequr që në momentin e parë që kam ardhur në punë, pasi nuk do të kisha besim, si rezultat i atyre pamjeve filmike që janë transmetuar⁹”*.

Duke patur parasysh sa më sipër, Komisioneri gjykon se Znj. shtë paragjykuar përfaktin se ka qenë dikur në ndjekje penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier dhe kjo ka ndikuar në zgjidhjen e kontratës së saj të punës me DRSSH Fier.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri gjykon se kemi të bëjmë me diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore të ankueses.

Në bazë të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka tagër për dhënie dëmshpérblimi moral (financiar), ndaj ankuesja duhet t’i drejtohet gjykatës, përfunduar këtë dëmshpérblim.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenet 12, 13 e 15, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërmë a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe referuar pikës 3 të Rregullores “Për personelin e ISSH-së”, të miratuar me Vendimin nr. 3/2, datë 26.02.2008 të Këshillit Administrativ të ISSH-së,

⁸ Realisht, ankuesja nuk ka punuar asnjëherë në pozicionin e punës së mjekes së KMCAP-së, por ka punuar në pozicionin e specialistës së degën e përfitimeve.

⁹ Z. referohet disa filmimeve, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me hetimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me Znj.

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të Znj. ga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, për shkak se ankuesja ka qenë e ndjekur penalisht në të kaluarën.
2. Rekomandojmë marrjen e masave të menjëherëshme nga ana e DRSSH Fier, për rikthimin në punë të Znj.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, DRSSH Fier të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

